

# PUNONJËSIT E POLICISË REKOMANDOJNË

*Ku dokument rekomandimesh paraqet një set rekomandimesh në mbështetje të gjetjeve të projektit “Ndërtimi i integritetit për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmëria e luftës kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri” i mbështetur nga Ambasada e Vendeve të Ulëta në Shqipëri. Dokumenti vjen si rezultat i një procesi të gjatë pune disa vjeçare dhe është konceptuar të jetë si udhëzues për autoritetet publike vendimmarrëse në miratimin e politikave për forcimin e integritetit të Policisë së Shtetit. Rekomandimet e paraqitura janë përmblylëse të sugjerimeve dhe diskutimeve të kryera me punonjësit e policisë gjatë aktiviteteve të ndryshme për komponentë të veçantë të projektit.*

*Në këtë kuadër, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim realizoi disa tryeza diskutimi me punonjës police me grada dhe nivele të ndryshme për çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e mekanizmave të integritetit dhe etikës policore. Këto tryeza diskutimi u zhvilluan përgjatë periudhës korrik 2019-janar 2021 dhe prodhuan një bazë të dhënash të plotë mbi integritetin policor, mbi luftën antikorrupsion në Policinë e Shtetit dhe sfida të tjera të polici të tilla: etika, performanca, e të tjerë mekanizma të integritetit. Mbështetur në diskutimet nga këto tryeza, por edhe nga gjetjet e rezultuara nga zbatimimi i komponentëve të tjerë të projektit, punonjësit e Policisë së Shtetit (PSH) konsiderojnë rekomandimet të mëposhtme për drejtuesit e strukturave qendrore policore me rëndësi të veçantë:*

## 1

## KUADRI I PËRGJITHSHËM I POLITIKAVE DHE KOORDINIMI

### **Analiza të bazuara në evidencë mbi çështjet në kuadër të politikave anti-korrupsion në Policinë e Shtetit dhe specifiktisht:**

- Kryerja e analizave të vlerësimit të risqeve për aspekte të veçanta të integritetit apo procese pune që janë më të ekspozuara ndaj risqeve të integritetit brenda strukturave policore;
- Kryerja e sondazheve periodike për të matur perceptimin publik mbi përvojën e qytetarëve me strukturat policore, të realizuara nga ofrues të pavarur dhe profesional, vendas dhe të huaj;
- Zbatimimi i legjislacionit në fuqi për kushtet e punës në Policinë e Shtetit (ligji Nr. 10.237 datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë” dhe 25 aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji); vlerësimi dhe monitorimi sistematik i kushteve të punës për punonjësit e PSH dhe garantimi që këto kushte të plotësojnë kërkesat operacionale. Kjo do të mundësonte një mjedis më të kënaqshëm pune për punonjësit e policisë;
- Kryerja e analizave sistematike të performancës së punës së punonjësve të policisë; Promovimi në detyrë duhet të jetë me baza meritokracie dhe i mbështetur në indikatorë dhe evidenca të qarta të performancës së punës;
- Kryerja e analizave dhe monitorimeve periodike për procesin e vetingut në polici.

### **Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinim më dinamik me aktorët publik dhe ato të interesit:**

- Forcimi i ndërveprimit institucional ndërmjet Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH) në shkëmbimin e informacionit përgjithësisht për të ndihmuar me auditime të shënjestruara dhe efektive të deklaratave të pasurive dhe interesave të punonjësve të policisë;
- Forcimi i bashkëpunimeve me aktorët e jashtëm të interesit dhe në veçanti me sindikatën e policisë, median dhe me shoqërinë civile.

### **Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së Policisë së Shtetit:**

- Publikimi i raporteve analitike vjetore të punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me tregues performance;
- Miratimi dhe publikimi i Programit të Transparencës në nivel të drejtorive rajonale vendore të PSH-së dhe për strukturat policore;
- Lehtësimi dhe rregullimi më i mirë për mekanizmat e raportimit dhe monitorimit të akteve korruptive dhe sjelljeve jo-etike të kryera nga punonjësit e policisë, me qëllim që të rritet vizibiliteti dhe ndërgjegjësimi mbi luftën kundër korrupsionit;
- Hartimi dhe miratimi i strategjisë së komunikimit për Policinë e Shtetit e cila përfshin edhe rritjen e ndërgjegjësimit për standardet e etikës;

### **Koordinim efektiv i Policisë së Shtetit me objektivat Strategjinë Kombëtare Anti-korrupsion 2013-2023 dhe Planin Përkatës të Veprimit:**

→ Hartimi dhe miratimi i Planeve të Integritetit për njësitë policore në vend në mbështetje të instrumentit metodologjik (të miratuar nga Ministria e Drejtësisë) afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit përkatës, si një nevojë e forcimit të sistemit të menaxhimit të integritetit në njësitë policore. Plani i Integritetit synon të krijojë një mënyrë sistematike për të identifikuar të gjitha proceset dhe praktikatat të cilat janë në kompleks të administruara nga organi-

zata policore si dhe për të identifikuar rreziqet që cenojnë mbarëvajtjen e çdo njësie policore;

- Fuqizimi me kapacitetet e Drejtorisë së Performancës dhe Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me fokus në koordinimin e zbatimit të procesit të planifikimit të integritetit nga njësitë policore si dhe monitorimin e tij;
- Inkurajimi i monitorimit të pavarur nga organizata të shoqërisë civile vendase dhe të huaja si dhe misionet policore që mbikëqyrin punën dhe bashkëpunojnë me Policinë e Shtetit.

## **2**

### **FORCIMI I MEKANIZMAVE EFEKTIV ANTI-KORRUPSION NË POLICINË E SHTETIT**

#### **Forcimi i mekanizmave të mbikëqyrës dhe të monitorimit që parandalojnë korrupsionin:**

- Kryerja e kontroleve periodike ndaj punonjësve të policisë për vlerësimin e njohurive mbi etikën, integritetin dhe sjelljen profesionale me qëllim që të kufizojnë sa më shumë prirjen e tyre drejt korrupsionit;
- Miratimi i udhëzimeve dhe rregulloreve të brendshme/kode sjelljeje për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në radhët e Policisë së Shtetit në nivel njësie policore;
- Sigurimi i sistemeve të duhura për të lehtësuar, përpunuar dhe vepruar në lidhje me ankesat për korrupsion dhe shkelje të etikës brenda strukturave policore (njësitë e sinjalizimit në strukturat policore. Garantimi i anonimitetit dhe konfidencialitetit për raportimin e sjelljeve jo etike ose korruptive brenda radhëve të policisë, duke u mbështetur në parashikimet ligjore të ligjit për sinjalizuesit;
- Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut mbi procedurat për raportimin dhe denoncimin e akteve korruptive të kryera nga Policia e Shtetit;
- Përmirësimi i mekanizmave për të parandaluar korrupsionin brenda Policisë së Shtetit si psh., zbatimi i testit të integritetit .

#### **Përmirësimi i performancës dhe profesionalizmit të punonjësve të Policisë së Shtetit**

- Zbatimi i një reforme të promovimit dhe karrierës në Policinë e Shtetit në mënyrë që

të përftohet një shërbim policor i bazuar në meritokraci dhe i motivuar – si një nevojë themelore për parandalimin e korrupsionit;

- Procedurat aktuale të ngritjes në detyrë për punonjësit e policisë të jenë më transparente duke bërë të mundur që punonjësit e policisë të kenë kohën e nevojshme për t'u përgatitur për testim;
- Rishikimi i niveleve të pagave të punonjësve të policisë, duke bërë të mundur që paga të përputhet më mirë me pritshmëritë e personelit;
- Përgatitja e projektvendimeve të Këshillit të Ministrave për trajtimin e punonjësve të Policisë së Shtetit me shpërblime financiare për vështirësitë e punës së tyre, mos kryerjen e lejeve të zakonshme, pagesat suplementare për transferimet jashtë vendbanimit të tyre familjar;
- Zbatimi i parashikimeve ligjore të Kodit të Punës dhe statusi i Policisë së Shtetit në lidhje me kohën e punës dhe të pushimit, punën jashtë orarit, ditët e festave zyrtare dhe ditët e shtuna e të diela.
- Ofrimi i shërbimit psikologjik në të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit për punonjësit e saj, për përmirësimin e shëndetit mendor dhe menaxhimin e stresit të punonjësve të policisë;
- Përditësimi i kurrikulave të trajnimit të vazhduar në përputhje me kërkesat e kohës për etikën dhe integritetin institucional.

Përgatitur nga: **Rovena Sulstarova • Armela Xhaho**

*Ky dokument rekomandimesh u realizua në kuadër të projektit: “Ndërtimi i Integritetit për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmëria e luftës kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri” i cili mbështetet nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Vendeve të Ulëta. Objektivat, zbatimi i plotë dhe rezultatet e këtij projekti janë përgjegjësi e organizatës zbatuese – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.*

*Qëndrimet apo opinionet e shprehura në këtë dokument janë të aktorëve të përfshirë në zbatimin e projektit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë Holandeze.*